REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2022:170020
Datë:	29.02.2024
Numri i dokumentit:	05392022

C.nr.2769/2022

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.S. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "Klinaku ....." me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Bejtulla Likaj nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 708.50 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T GJ Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.S. nga Prizreni.

II. **DETYROHET** e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, që paditësit F.S. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t`ia paguaj **shumën e përgjithshme prej 659.77 euro,** me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 22.08.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit, dhe atë kërkesa në lartësi prej 48.73 €, **e pabazuar.**

IV. **OBLIGOHET** e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi F.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "Klinaku ....." me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, me datë 22.08.2022 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 708.50 euro,.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, për më tepër se 10 vite në SHSKUK, në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratën Sektoriale e nënshkruar me 12.06.2018, mes Qeverisë së Kosovës-

2022:170021

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, nuk e ka bërë kompensimin e 1 (një) pagës neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së një page neto për shpërblimin jubilar, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditësit. Sipas të autorizuarit të paditësit paga mujore neto e të njëjtit është 708.50 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se paditësi marrëdhënien e punës në SPZ e ka filluar me datë 01.02.2015. Sipas të njëjtit kërkesa e paditësit është pa bazuar pasi i njëjti kërkesën e Bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, neni 52 dhe 53. Pagesën për shpërblimin jubilar e ka kundërshtuar pasi bazuar në Ligjin e punës, nr.03/L-212, neni 87, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) viteve. Paragrafi 3 i këtij neni ka paraparë se shpërblimet jubilare paguhen në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushtit nga ky paragraf, që do të thotë se shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji prej ditës kur i punësuari mbush 10, 20 dhe 30 vjet përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut. Ndërsa sa i përket lartësisë shumës së kërkuar ka theksuar se në kërkesë nuk është llogaritur paga bazë, por në mënyrë paushallë edhe vlerat e tjera ku përfshihen kujdestaritë, pra paga bazë e paditësit është 659.77 euro e jo 708.50 euro. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të merr aktgjykim me të cilin kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të padituërës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Spitalin e Përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Nga lista e pagave me nr. EM00114978 lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Fatbardh Skeraj, pagën mujore bazë e ka në shumën prej 659.00 euro si dhe përvoja e punës tek e paditura është 13 vite.

Nga vërtetimi me nr. amz.1284 i datës 19.07.2021, lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.S. është në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar pranë Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren nga data 01.02.2015 dhe në këtë institucion i ka 6 vite e 6 muaj e 12 ditë përvojë pune, ndërsa në total i ka 12 vite e 5 muaj e 12 ditë përvojë pune dhe paga e fundit bazë është 659.77 euro.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të".* Andaj pasi ky vërtetim lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj me datë 19.07.2021 vërteton fakti se i padituri i ka 10 vite përvojë pune dhe i njëjti e ka pagën bazë mujore 659.77 euro.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të dt.12.06.2018, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 12.06.2018.

Me nenin 17 par.3,të Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të dt.12.06.2018, është paraparë se "*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: "për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tre paga mujore të tij"*.

Po ashtu bazuar edhe në Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, ku në pikë V përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që "*punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) <u>që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V</u>, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit*".

Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësi në periudhën për të cilën aplikohet kontrata kolektive sektoriale (11.06.2018 - 10.06.2021) i ka arritur 10 vjet përvojë pune saktësisht me datë 19.07.2018 që do të thotë se është përmbushur kushti kryesor sipas nenit 17 për fitimin e shpërblimit jubilar prej një page mujore. Mbi këtë bazë gjykata konstaton se kërkesa e palës paditëse është paraqitur brenda periudhës kur KKS ka zbatueshmëri dhe e njëjta i përmbush të gjitha kushtet për kompensim.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor në institucionin shëndetësor, t'ia paguaj kompensimin për shpërblimin jubilar, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të datës 12.06.2018, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me shpërblimin jubilar për paditësin F.S. në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 659.77 euro, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke u bazuar në nenin 17 par 3, nenpar.3.1, të kontratës së lartcekur, pasi që për të njëjtin kërkesa për kompensimin e shpërblimit jubilar është bërë e arritshme, konkretisht për 10 vite përvojë pune, t`ia kompnesoj një pagë mujore.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ku rezultoi se kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së aprovuar, e të cekur në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë kërkesa në lartësi prej 48.73 €, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për paditësin F.S. nga Prizreni të refuzohet si e pabazuar, pasi gjykata përmes provave të paraqitura nga vet pala paditëse lidhur me përvojën e punës (i njëjti ka 10 vite përvojë pune) dhe pagës bazë të tij (vlera e pagës bazë mujore është 659.77 euro, i rezultoi se e njëjta bazuar ne nenin 17 par.3, nën par.3.1 e 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot. 05-3815, të datës 12.06.2018, duhet ti paguhet një pagë bazë mujore të tij e që është shuma e përgjithshme prej 659.77 euro e jo vlera e kërkuar si në kërkesëpadi. Kjo pasi që si pagë mujore konsiderohet paga bazë dhe jo pagesa të cilën e merr punëtori së bashku me shtesat tjera ku përfshihen pagesat për

kujdestarinë. Për të bërë përkufizimin se çka nënkupton pagë dhe pagë shtesë, gjykata i'u referua Ligji të Punës i cili në nenin 55 par. 2, parasheh se *i punësuari: " ka të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës"*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivit nën I dhe II të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë"* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e themeltë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia".*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro dhe përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 124.00 euro.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:170020, 29.02.2024

Gjyqtari

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.